

Tiranë më, 30.03.2018


VËRTETIM

Me anë të kësaj shkrese vërtetojmë se MAZARS sh.p.k është angazhuar për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë "**FOOD TRADE sh.p.k.**" me NIPT K61704029H dhe seli të regjistruar në adresën: Autostrada Tiranë Durrës km.6, Tiranë për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017.


Ne nuk e kemi përfunduar ende procesin e auditimit dhe në këtë moment nuk jemi në gjendje të lëshojmë raportin e auditimit.

E lëshojmë këtë vërtetim, sipas kërkesës së shoqërisë "**FOOD TRADE sh.p.k.**".

MAZARS sh.p.k



Irena Hoxha (Pulo)
Auditues Ligjor

 MAZARS

Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirane, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

FOOD TRADE sh.p.k

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
PASQYRAT FINANCIARE	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL NETO	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5 – 25

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë material	6	253,108,837	269,083,028
Aktivët afatgjatë jomateriale	7	27,672,092	46,993,387
Parapagime dhe shpenzime të shtyra afatgjatë	8	92,591,510	85,164,167
Totali i aktiveve afatgjatë		373,372,439	401,240,582
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë	9	278,172,950	292,346,057
Llogari të arkëtueshme tregtare	10	14,171,700	61,654,007
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	11	27,755,058	107,774,799
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	9,369,060	12,814,233
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	13	14,867,687	17,665,108
Mjetet monetare në arkë e në bankë	14	127,380,640	140,415,689
Totali i aktiveve afatshkurtra		471,717,095	632,669,893
Totali i aktiveve		845,089,534	1,033,910,475
KAPITALI			
Kapitali nënshkruar		148,963,500	148,963,500
Rezerva ligjore		1,101,320	1,101,320
Fitime të mbartura		(13,833,551)	10,640,563
Fitimi i ushtrimit		37,473,093	(24,474,114)
Totali i kapitalit	15	173,704,362	136,231,269
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	16	10,382,973	36,905,149
Hua afatgjatë nga ortakut	17	59,888,734	60,915,785
Totali i detyrimeve afatgjatë		70,271,707	97,820,934
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	18	26,434,425	134,837,874
Llogari të pagueshme tregtare	19	85,424,562	90,506,213
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	20	450,016,907	540,715,087
Parapagimet e arkëtuara	21	75,678	257,928
Detyrime tatimore	22	29,916,090	25,901,478
Llogari të pagueshme të tjera	23	9,245,803	7,639,692
Totali i detyrimeve afatshkurtra		601,113,465	799,858,272
Totali i detyrimeve		671,385,172	897,679,206
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		845,089,534	1,033,910,475

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	24	2,319,702,863	2,357,043,388
Të ardhura të tjera	25	36,662,068	49,058,060
Total të ardhura		2,356,364,931	2,406,101,448
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	26	(1,789,383,156)	(1,867,275,955)
Shpenzime personeli	27	(118,461,928)	(114,545,113)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	28	(94,561,053)	(87,931,105)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	29	(311,092,315)	(358,856,349)
Total shpenzime		(2,313,498,452)	(2,428,608,522)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	30	(1,844,841)	(4,512,609)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	31	2,790,086	2,545,569
Fitimi/humbja para tatimit		43,811,724	(24,474,114)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	32	(6,338,631)	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(6,338,631)	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		37,473,093	(24,474,114)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		37,473,093	(24,474,114)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FOOD TRADE sh.p.k

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto
Për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2017


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2016	148,963,500	721,256	3,419,345	7,601,282	160,705,383
Fitim/humbja e vitit				(24,474,114)	(24,474,114)
Transferimi në fitime të mbartura			7,221,218	(7,221,218)	-
Transferimi në rezervë ligjore		380,064		(380,064)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirë për vitin					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	148,963,500	1,101,320	10,640,563	(24,474,114)	136,231,269
Fitim/humbja e vitit					-
Transferim në fitime të mbartura			(24,474,114)	37,473,093	37,473,093
Transferimi në rezervë ligjore				24,474,114	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirë për vitin:					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	148,963,500	1,101,320	(13,833,551)	37,473,093	173,704,362

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më ____ mars 2018 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

Znj. Artenida Dule

Përgatitës i pasqyrave financiare

Z. Q. Tafuni
Administrator



Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	43,811,724	(24,474,114)
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	80,873,813	82,544,984
Zhvlerësimi		
Shpenzime për interesa	1,854,398	4,596,836
Tatimi mbi fitimin	(6,338,631)	-
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	14,173,107	(12,841,952)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	127,357,575	(26,677,616)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	(92,410,727)	44,998,002
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(4,812,172)	17,448,297
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	164,509,092	85,594,437
Interesa të paguara	(1,854,398)	(4,596,836)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(573,789)	(3,178,581)
	(2,428,187)	(7,775,417)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(43,713,256)	(50,107,430)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	4,549,978	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(39,163,278)	(50,107,430)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	(27,549,227)	(60,687,906)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër	(108,403,449)	78,699,311
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(135,952,676)	18,011,405
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(13,035,049)	45,722,995
Mjetet monetare në fillim të periudhës	140,415,689	94,692,694
Mjetet monetare në fund të periudhës	127,380,640	140,415,689

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria FOOD TRADE është regjistruar me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë datë 03/04/2006. NIPT-i shoqërisë është K61704029H.

Shoqëria ka si objekt menaxhimin, blerjen, marrjen me qira, ndërtimin, dhënien me qira ose në menaxhim, sikurse edhe shitjen e aktiviteteve tregtare me shumicë apo me pakicë dhe të veprave dhe strukturave që kanë lidhje me keto aktivitete; ndërtimin, menaxhimin dhe shitjen e dyqaneve për shitje të mallrave me shumicë ose pakicë, për llogari të vet apo të të tretëve: blerjen e mallrave ushqimore të përgjithshme, në bashkëpunim me shoqëri dhe entitete të tjera, si dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme që do të jenë objekt i aktivitetit tregtar.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 148,963,500 lekë i cili zotërohet nga ortakët e shoqërisë.

Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në autostradën Tiranë-Durrës, km. 6 Kashar, Tiranë.

Administratori i shoqërisë është z.Pietro Tafuni.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 231 punonjës (2016: 210).

2. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2017 ose pas kësaj date:

- *Përmirësimet vjetore të SNRF (Cikli 2014 - 2016):* SNRF 12 - Shpalosjen e interesave në njësi të tjera
- *SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat* (Amendim – Njohja e taksës së shtyrë si aset për humbje të porealizuara)
- *SNK 7 Pasqyra e Flukseve Monetare* (Shpalosjen e Amendimeve fillestare)

Nuk ka patur standarde apo interpretime të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2017 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël të cilat bëhen efektive në periudhat e ardhshme kontabël dhe që Shoqëria nuk ka vendosur ti përvetësojë më shpejt. Më të rëndësishmet janë:

- *SNRF 9 Blerësit e instrumentave financiar* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date).
- *SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me blerësit* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date).
- *SNRF 16 Qiratë* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2019 ose pas kësaj date).
- *Të tjera*

Shoqëria nuk parashikon standarde të tjera të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël, që nuk janë në përdorim, të kenë ndikim material në pasqyrat financiare.

- *KIRFN 22 Përkthimin e Monedhave të huaja dhe Vlerësimin në Avancë* (në fuqi më 1 Janar 2018);
- *Amendime të klasifikimeve të SNRF 2 dhe Matja e Transaksioneve me Pagesë Aksionesh* (në fuqi më 1 Janar 2018);
- *Amendime të SNA 40: Transfertat e Pasurive Investuese* (në fuqi më 1 Janar 2018);

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuar (vazhdim)

- *Përmirësime vjetore të Standardeve SNRF, cikli 2014 – 2016, që ndeshet me çështjet e SNRF 1 për herë të pare;*
- *Adoptimi dhe SNA 28 Investime në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (në fuqi më 1 Janar 2018);*
- *KIRFN 23 Paqartësi mbi Pozicionin e Taksës mbi të Ardhurat (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)*
- *Amendime të SNRF 9 Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ (hyn në fuqi më 1 Janar 2019);*
- *Amendime të SNA 28: Interesat Afatgjatë në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (hyn në fuqi më 1 Janar 2019);*
- *SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (hyn në fuqi më 1 Janar 2021).*

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat financiare janë paraqitur për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017.

3.2 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.

3.3 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.4 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.5 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**3.6 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël, të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga shoqëria.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Euro / LEK	132.95	135.23
USD / LEK	111.10	128.17

4.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare ç' regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare ç' regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera janë deklaruar me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë

Huatë janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksioneve dhe më pas njihen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me shpenzime interesi të njohura bazuar në normën efektive.

Metoda e interesit efektiv është metoda e llogaritjes së koston së amortizuar të detyrimit financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht vlerat e ardhshme të parave përgjatë jetëgjatësisë së planifikuar të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër vlerën e mbetur neto nga njohja fillestare.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar, sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.3 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve, në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme, duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e ç'montimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndarë (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera, në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës, në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë, në bazë të vlerës së mbetur:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit ne %
Makineri dhe pajisje	20%
Mjetet e transportit	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike, që burojnë nga aktivet afatgjata materiale.

Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.5 Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

4.6 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.7 Pagesat e qirasë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë, me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

4.8 Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit, që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.9 Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit, sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shumën e mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime, në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.10 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin e pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.12 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme, për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave. Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 (iii), Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç' regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe, në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual, si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit, e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.



FOOD TRADE sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

6. Aktivet afatgjata materiale

Aktivt afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

<i>Kosto</i>	Mjete transporti	Mobilije e pajisje zyre	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	15,127,095	413,376,101	428,503,196
Shtesa	1,030,782	48,558,151	49,588,933
Gjendja më 31 dhjetor 2016	16,157,877	461,934,252	478,092,129
Shtesa	1,107,006	42,118,663	43,225,669
Pakësime	-	(4,758,904)	(4,758,904)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	17,264,883	499,294,011	516,558,894
<i>Amortizimi i akumuluar</i>			-
Gjendja më 1 janar 2016	6,937,424	139,256,585	146,194,009
Amortizimi i vitit	1,671,171	61,143,922	62,815,093
Pakësime	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	8,608,595	200,400,507	209,009,102
Amortizimi i vitit	1,677,677	56,073,958	57,751,635
Zhvlerësim CP	-	(2,541,671)	(2,541,671)
Pakësime	-	(769,009)	(769,009)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	10,286,272	253,163,785	263,450,057
<i>Vlera neto kontabël</i>			
Gjendja më 31 dhjetor 2016	7,549,283	261,533,745	269,083,028
Gjendja më 31 dhjetor 2017	6,978,611	246,130,226	253,108,837

7. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale paraqitet si më poshte më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	AAJM	Total
<i>Me kosto</i>		
Gjendja më 1 janar 2016	131,474,054	131,474,054
Shtesa	518,496	518,496
Transferime	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	131,992,550	131,992,550
Shtesa	487,587	487,587
Transferime	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	132,480,137	132,480,137
<i>Amortizimi</i>		
Gjendja më 1 janar 2016	65,269,272	65,269,272
Amortizimi i vitit	19,729,891	19,729,891
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	84,999,163	84,999,163
Amortizimi i vitit	19,808,882	19,808,882
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2017	104,808,045	104,808,045
<i>Vlera neto kontabël</i>		
Gjendja më 31 dhjetor 2016	46,993,387	46,993,387
Gjendja më 31 dhjetor 2017	27,672,092	27,672,092

8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra afatgjata

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Investime në ambjente të marra me qera	92,591,510	85,164,167
	92,591,510	85,164,167

Shoqëria ka paraqitur në shpenzime të shtyra, vlerën e investimeve të kryera në ambjente të marra me qira, të cilat amortizohen mbi bazën e kohëzgjatjes së kontratës.

9. Inventari

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mallra	271,715,647	286,257,790
Inventar i imët	10,160,917	9,426,580
Zhvlerësim inventari imët	(3,703,614)	(3,338,313)
	278,172,950	292,346,057

10. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë	14,171,700	61,654,007
	<u>14,171,700</u>	<u>61,654,007</u>

11. Llogari të arkëtueshme nga palë të lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Conad Albania sh.p.k	27,755,058	107,774,799
	<u>27,755,058</u>	<u>107,774,799</u>

12. Llogaritë të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime të arkëtueshme	9,369,060	10,639,037
Tatim mbi fitimin	-	2,175,196
	<u>9,369,060</u>	<u>12,814,233</u>

13. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime të tjera	11,084,067	14,861,542
Shpenzime të shtyra për tu shpërndarë në disa periudha	3,783,620	2,803,566
	<u>14,867,687</u>	<u>17,665,108</u>

14. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	21,379,229	70,595,038
Në lekë	17,185,260	66,823,736
Në valutë	4,193,969	3,771,302
Likuiditet në arkë	106,001,411	69,820,651
Në lekë	106,001,411	69,820,651
Në valutë	-	-
	<u>127,380,640</u>	<u>140,415,689</u>

15. Kapitali

Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 ka qenë: 148,963,500 Lekë (2016: 148,963,500 Lekë)

Rezerva ligjore

Rezervat ligjore të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 kanë qenë në vlerën 1,101,320 Lekë (2016: 1,101,320 Lekë)

Fitim/(Humbje) të mbartura

Shuma prej (13,833,551) Lek përfaqëson humbjen e mbartur nga viti parardhës (2016: 10,640,563 Lek përfaqëson fitimin e mbartur nga viti parardhës)

Fitimi/(humbje) i/(e) ushtrimit

Shuma prej 37,473,093 Lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit përgjatë vitit 2017.

16. Huaja afatgjatë

Huaja afatgjatë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua afatgjatë	10,382,973	36,905,149
	<u>10,382,973</u>	<u>36,905,149</u>

Shoqëria ka hyrë në marrëdhënie huaje me Veneto Bank, norma e interesit për huanë është e barabartë me normën vjetore të EURIBOR 1 muhor + një normë prej 2% por asnjëherë përqindja e interesit nuk mund të jetë më pak se 3%, si dhe me Societe General Albania Bank norma e interesit e të cilës është e barabartë me Libor 12 muhor + 3.5% por asnjëherë më pak se 4%.

17. Hua afatgjatë nga ortakët

Huaja afatgjatë përbëhet më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua nga ortakët	59,888,734	60,915,785
	<u>59,888,734</u>	<u>60,915,785</u>

18. Hua afatshkurtër

Huaja afatshkurtër përbëhet më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Overdraft Societe Generale	-	54,179,312
Overdraft Intesa SanPaolo	663,324	52,577,335
Overdraft American Bank of Investment	174	1,935
Overdraft Veneto Bank	-	12,982
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	25,770,927	28,066,310
	<u>26,434,425</u>	<u>134,837,874</u>

19. Llogari të pagueshme tregtare

Në këtë zë janë përfshirë llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të pagueshme tregtare	75,761,855	82,449,492
Furnitorë për fatura të pambërritura	9,662,707	8,056,721
	<u>85,424,562</u>	<u>90,506,213</u>

20. Llogari të pagueshme nga palët të lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
E.H.W sh.p.k	5,067,689	4,806,116
Conad Shqipëria sh.p.k	232,220	4,927,981
Conad Albania sh.p.k	444,716,998	530,980,990
	<u>450,016,907</u>	<u>540,715,087</u>

21. Parapagimet e arkëtuara

Parapagimet e arkëtuara më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime nga klientë	75,678	257,928
	<u>75,678</u>	<u>257,928</u>

22. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,536,130	2,126,070
Tatimi mbi të ardhurat personale	774,433	1,130,110
TVSH për t'u paguar	22,237,123	22,062,783
Tatim në burim	778,758	582,515
Detyrimi tatim fitimit	3,589,646	-
	<u>29,916,090</u>	<u>25,901,478</u>

23. Llogari të pagueshme të tjera

Llogarit e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Paga për t'u paguar	9,245,803	7,552,928
Detyrime të tjera	-	86,764
	<u>9,245,803</u>	<u>7,639,692</u>

24. Të ardhura

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	2,319,702,863	2,357,043,388
	<u>2,319,702,863</u>	<u>2,357,043,388</u>

25. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura të tjera	4,447,268	15,708,595
Të ardhura nga qeraja	32,214,800	33,349,465
	<u>36,662,068</u>	<u>49,058,060</u>

26. Materiale të para dhe të konsumueshme

Në këtë zë paraqitet kostoja e mallrave të shitur që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Kostoja e mallrave të shitur paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Mallra	1,774,841,013	1,879,027,963
Ndryshim gjendje inventari	14,542,143	(11,752,008)
	<u>1,789,383,156</u>	<u>1,867,275,955</u>

27. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	102,324,366	99,855,748
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	16,137,562	14,689,365
	<u>118,461,928</u>	<u>114,545,113</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 231 punonjës (2016: 210 punonjës)

28. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime amortizimi	94,561,053	82,544,987
Shpenzime zhvlerësimi për llogari të tjera të arkëtueshme	-	5,386,118
	94,561,053	87,931,105

29. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Blerje energji, avull, ujë karburant	35,558,240	33,981,053
Shpenzime transporti	14,877,341	18,865,508
Mirëmbajtje dhe riparime	20,727,211	16,316,532
Sigurime	14,712,315	14,165,410
Udhetime e dieta	50,920	35,120
Shpenzime administrative	37,364,458	36,250,678
Qera	151,650,828	166,453,289
Shpenzime ligjore e konsulenca	1,009,136	3,742,500
Lëndë djegëse	1,667,745	999,573
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,547,648	1,762,384
Publicitet, reklama	152,641	148,220
Komisione dhe tarifa bankare	5,384,366	7,762,412
Tatime dhe taksa të tjera	7,417,823	6,452,758
Pagesa për honorare, ndërmjetës	675,400	18,600
Gjoha e demshperblime	179,765	414,808
Uniformat e punonjësve	1,039,833	1,529,033
Fitim/humbje nga shitja e aktiveve afatgjata	208,926	-
Te tjera shpenzime	16,867,719	49,958,471
	311,092,315	358,856,349

30. Shpenzime dhe të ardhurat nga interesi dhe te ngjashme (neto)

Shpenzimet e interesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për interesa hua	(1,854,398)	(4,596,836)
Të ardhura nga interesat	9,557	84,227
	(1,844,841)	(4,512,609)

31. Shpenzime të tjera financiare (neto)

Humbjet nga këmbimet valutore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime nga këmbimet valutore	(662,034)	(878,593)
Të ardhura nga këmbimet valutore	3,452,120	3,424,162
	<u>2,790,086</u>	<u>2,545,569</u>

32. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<i>Fitimi para tatimit</i>	43,811,724	(24,474,114)
Total shpenzime të panjohura	2,853,776	20,066,157
Penalite, gjoba e dëmshpërblime	179,765	414,808
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	-	5,386,118
Shpenzime zhvlerësimi nga mbyllja e dyqanit	2,108,023	14,069,899
Shpenzime të tjera të pazbritshme	565,988	195,332
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>46,665,500</u>	<u>(4,407,957)</u>
Humbje fiskale e mbartur	(4,407,957)	-
Fitimi i tatueshëm	42,257,543	-
<i>Tatim fitimi @15%</i>	6,338,631	-
Fitimi/humbja e Vitit	<u>37,473,093</u>	<u>(24,474,114)</u>

FOOD TRADE sh.p.k

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

33. Palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet e mëposhtëme vijnë nga aktiviteti i përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
E.H.W Sh.p.k.	-	5,067,689	-	4,806,116
Conad Shqiperia Sh.p.k.	-	232,220	-	4,927,981
Conad Albania Sh.p.k.	27,755,058	444,716,998	107,774,799	530,980,990
	27,755,058	450,016,907	107,774,799	540,715,087

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
E.H.W Sh.p.k.	1,650,864	35,965,272	604,892	22,552,585
Conad Shqiperia Sh.p.k.	-	-	-	-
Conad Albania Sh.p.k.	78,030,451	1,617,161,327	66,416,470	1,695,911,369
Qafshatama Sh.p.k.	175,982	-	60,753	-
	79,857,297	1,653,126,599	67,082,115	1,718,463,954

34. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

	31 dhjetor	
	2017	2016
Instrumenta me interesa fiks		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	-	-
Instrumenta me interesa variable		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	10,382,973	36,905,149
	10,382,973	36,905,149

Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

34. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Llogari të arkëtueshme	14,171,700	61,654,007
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	27,755,058	107,774,799
Llogari të tjera të arkëtueshme	9,369,060	12,814,233
Paraja dhe ekuivalentët e saj	127,380,640	140,415,689
Totali	<u>178,676,458</u>	<u>322,658,728</u>

Mosha e llogarive të arkëtueshme paraqitet më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Deri në 6 muaj	35,900,144	112,086,014
6 deri 12 muaj	1,727,724	16,839,224
1 deri 5 vjet	4,298,890	40,503,568
Mbi 5 vjet	-	-
Shuma bruto	<u>41,926,758</u>	<u>169,428,806</u>

34. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristikë likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkuesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profitet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2017			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet
				Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	51,295,818	-	-	51,295,818
Mjete monetare në arkë dhe bankë	127,380,640	-	-	127,380,640
Totali	178,676,458	-	-	178,676,458
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(574,603,362)	-	-	(574,603,362)
Hua	(15,005,444)	(13,167,163)	(8,644,791)	(36,817,398)
Totali	(589,608,806)	(13,167,163)	(8,644,791)	(611,420,760)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2017	(410,932,348)	(13,167,163)	(8,644,791)	(432,744,302)

Përshkrimi	31 dhjetor 2016			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5vjet	Mbi 5vjet
				Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	182,243,039	-	-	182,243,039
Mjete monetare në arkë dhe bankë	140,415,689	-	-	140,415,689
Totali	322,658,728	-	-	322,658,728
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(664,762,472)	-	-	(664,762,472)
Hua	-	(134,837,874)	(36,905,149)	(171,743,023)
Totali	(664,762,472)	(134,837,874)	(36,905,149)	(836,505,495)
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	(342,103,744)	(134,837,874)	(36,905,149)	(513,846,767)

34. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2017			Total
	EUR	LEK	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	51,295,818	-	51,295,818
Mjete monetare në arkë dhe bankë	4,772,036	122,608,604	-	127,380,640
Totali	4,772,036	173,904,422	-	178,676,458
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(9,503,505)	(565,099,857)	-	(574,603,362)
Hua	(34,415,892)	(2,401,506)	-	(36,817,398)
Totali	(43,919,397)	(567,501,363)	-	(611,420,760)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2017	(39,147,361)	(393,596,941)	-	(432,744,302)

Përshkrimi	31 dhjetor 2016			Total
	EUR	ALL	USD	
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	182,243,039	-	182,243,039
Mjete monetare në arkë dhe bankë	3,771,302	136,644,387	-	140,415,689
Totali	3,771,302	318,887,426	-	322,658,728
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(7,214,246)	(567,548,226)	-	(664,762,472)
Hua	(60,304,695)	(111,438,328)	-	(171,743,023)
Totali	(67,518,941)	(678,986,554)	-	(836,505,495)
Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2016	(63,747,639)	(360,099,128)	-	(513,846,767)

35. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiare përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

36. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

37. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

38. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.



Subjekti **FOOD TRADE SHPK**
NIPT **K61704029H**

Inventari automjeteve ne pronesi te subjektit 31.12.2017

Nr.	Lloji I automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera
1	FIAT GRANDE PUNTO	4+1	AA 342 HT	12,300 €
2	FORD FUSION	4+1	TR 8704 P	14,450 €
3	FORD TRANSIT	5+1	TR 2639 P	21,500 €
4	FORD C-MAX	4+1	TR 2060 K	6,500 €
5	FORD KUGA	4+1	AA 361 LM	27,850 €

Administratori
PIETRO TAFUNI



FOOD TRADE
SH.P.K
K 61704029H
BUL. "BAJRAM CURRI" ETCITIRANË